



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

02.Nr.151/2011

Dt:15/03/2011

Duke u bazuar në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale nr 03/L-040 neni 66.2 dhe 66.3, Ligjin e shërbyesve Civil nr 03/L-149 neni 11, neni 18 paragrafi 1, Rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010, Statutin e Komunës neni 81 si dhe pas miratimit dhe autorizimit për rekrutim nga Ministria e Administratës Publike nr. 1381, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit rishpall këtë:

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës: Udhëheqës/e i/e Personelit

Kategoria dhe grada : (koeficienti 9.5)¹

Kohëzgjatja e kontratës: periudha provuese një vjeqare

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Bashkërenditjen e planifikimit të burimeve njerëzore dhe administrimin e punësimit të personelit
- Udhëheqjen motivimin e ekipit të personelit, për të ngritur nivelin e përkushtimit (mënyrës së kryerjes së punës) dhe për të dhënë shërbime cilësore.
- Sigurimin e funksionimit të përditshëm të procedurave siç janë: rekrutimi dhe përzgjedhja, disiplina, ankesat, lutjet, vlerësimet, e përgjithshme në konsultimet me menaxherët e drejtpërdrejt, duke përfshirë edhe trajnimet e paneleve dhe komisioneve të nevojshme për t'i vënë në funksion këta procedura.
- Krijimin dhe mirëmbajtjen e komunikimit efektiv dhe bashkëpunimin me të gjitha funksionet në Komunë, në lidhje me çështjet e burimeve njerëzore.
- Sigurimin e integritetit të parimeve të mundësive të barabarta në të gjitha aspektet e punës së njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore.
- Kontributin në zhvillim dhe arritje të standardeve kualitative të administrimit dhe veprimtarisë së Komunës siç janë: disiplina në punë dhe vlerësimi i rregullit i të arriturave në punë.
- Kryen edhe punë të tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës, dhe të përcaktuara me ligj.

¹ Kategoria dhe grada për këtë pozitë do të përcaktohet me nxjerrjen e aktit nënligjor nga Ministria e Administratës Publike

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim: Kandidatët për këtë vend pune duhet ti plotësojnë këto kushte:

- Të kenë përgaditje superiore (preferohet fakultetin e Administratës Publike ose fakultetin Juridik)
- Të kenë së paku 1 vjet përvojë pune në menaxhim të personelit
- Të njohë punën në Kompjuter (Word, Excel, etj.)
- Aftësi për të krijuar raporte të mira pune dhe ndërpersonale
- Aftësi të theksuara komunikimi në të shkruar dhe në të folur
- Preferohet të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze
- Referencë, mirënjohje apo çertifikatë të ndonjë institucioni apo organizate

Procedura e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin e Shërbyesve civil dhe rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010 e cila e rregullon rekrutimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Formularët e aplikimit mund të merren në zyrën e pritjes, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00 dhe do të dorëzohen po ashtu në zyrën e pritjes në objektin e Komunës kati i parë.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes si dhe çertifikata tjera mbi trajnimet e kryera.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor.

Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë në numrin e telefonit 0290/ 385-108.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjestarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

**Kryetari i Komunës
Rufki Suma**
